



Në mbështetje të nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit, nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3 paragrafi 1, i Ligjit, nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, pastaj nenin 4 të Udhëzimit Administrativ, nr. 21/2014, dhe të nenit 4, paragrafi 1 të Udhëzimit administrativ, nr. 23/2010 për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit, Komuna e Klinës në bazë të përcaktimit të kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar që mund të fitojnë nga Programet e veçantë të banimit, në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi, jep banesë me qira joprofitabile sipas marrëveshjes dhe bën shpalljen publike të:

KONKURSI

Data-Date-Datum

22.10.2019

Komuna e Klinës ka siguruar Program të veçantë të banimit për familjet që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit, duke ndarë banesë me qira joprofitabile për të krijuar kushte të përshtatshme për banim.

☐ Kanë të drejtë të jenë përfitues të këtij programi vetëm familjet që:

1. Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
2. Kanë mbetur pa banesë/shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë;
3. Posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.
4. Familje që jetojnë në objekte të huaja me ose pa qira.

☐ **Përcaktimi i familjeve përfituese bëhet mbi bazën e kriterëve të përparësisë si vijon më poshtë:**

- a. Statusi i banimit;
- b. Lartësia e të ardhurave;
- c. Gjendja shëndetësore;
- d. Invaliditeti i pjesëtarëve të familjes dhe
- e. Përbërja/struktura familjare.

☐ Kriteret shtese sipas strukturës së familjes të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 2 i UA të MMPH-së, nr.21/2010 janë si vijon:

- Familja e dëshmorit, invalid dhe veteran i luftës së UÇK-së;
- Familja e kryesuar nga një prind/prindi vetushqyes;
- Familja që ka në mbikëqyrje/përkujdesje fëmijët jetimë.

☐ Aplikuesit që bëjnë kërkesë për të përfituar nga ky Program i banimit, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe banorë të përhershëm të Komunës së Klinës së paku 5 (pesë) vite para kohës së aplikimit.

☐ Për zgjedhjen e përfituesve nga Programi i veçantë i banimit përparësi kanë familjet me numër më të madh të pikëve, sipas tabelës së vlerësimit të përcaktuar në shtojcën 1 të Udhëzimit administrativ, nr. 21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit.

- ☐ Në rast se aplikuesit pas vlerësimit arrijnë numër të njëjtë të pikëve, atëherë përparësi do të kenë familjet me më shumë anëtarë” (sipas nenit 5, paragrafi 4, të Udhëzimit administrativ, nr. 21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit).
- ☐ Komuna ka në dispozicion për këtë program të veçantë të banimit 4 (katër) njësi banesore, 2 njësi në objektin “Benita”, rruga “Abedin Rexha”, 1 njësi në objektin “Mirusha”, rruga “Dëshmorët e Kombit”, si dhe 1 njësi në objektin e dytë social, nr. 2 “sheshi “Faruk Elezaj”, të cilat i jep me qira joprofitabile për familjet të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.
- ☐ Organi komunal kompetent bën shpërndarjen e aplikacioneve pa pagesë, në formë standarde, për të gjithë aplikuesit e interesuar, ndërkaq të gjithë aplikuesit të njëjtat mund t’i marrin në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Klinës, rruga “Abedin Rexha” pn, kati I, çdo ditë pune prej orës 8:30 deri në orën 15:00.
- ☐ Kërkesa e plotësuar dhe dokumentacioni i nevojshëm dorëzohen dhe pranohen në Komunë çdo ditë pune.
- ☐ Konkursi mbetet i hapur 30 (tridhjetë) ditë nga dita e shpalljes publike në njërën nga gazetatat e përditshme, duke filluar prej dt. **22.10.2019** deri me **dt.20.11.2019**, ndërsa raporti dhe dokumentacioni i kompletuar i përcillet Komisionit vlerësues brenda 5 (pesë) ditësh.
- ☐ Komisioni vlerësues për përzgjedhjen e familjeve bën shqyrtimin e gjendjes së banimit dhe të të dhënave të tjera të nevojshme të aplikuarve brenda 30 (tridhjetë) ditëve, ndërkaq brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasuese do të bëjë vlerësimin dhe verifikimin në terren të parashtruesit të kërkesës.
- ☐ Aplikacionet e dorëzuara pas afatit kohor, të pakompletuara dhe të paplotësuara me të dhënat e nevojshme, nuk do të pranohen dhe do të konsiderohen të pavlefshme.
- ☐ Kur aplikuesi me vetëdije jep deklaratë të rrejshme apo paraqet dokumentacion të falsifikuar, humb të drejtën për t’u kualifikuar si shfrytëzues i këtij programi të banimit social.
- ☐ Ndalohet bërja publike e të dhënave mbi procesin e përzgjedhjes para publikimit të listës së familjeve të përzgjedhura.
- ☐ Përfshihen nga përfitimi nga ky program familjet që kanë përfituar ndihmë në forma të tjera të të njëjtit nivel ose me të lartë sesa mund të përfitohet nga programet e veçanta të banimit.
- ☐ Komuna në tabelën e shpalljeve do të publikojë listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit.
- ☐ Përfituesve iu ndahet banesa në shfrytëzim në afat të pacaktuar, me vlerësim të gjendjes ekonomike për çdo vit sipas dispozitave të Ligjit nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit
- ☐ Pas shpalljes së listës, familjeve të renditura sipas pikëve të fituara dhe kundër Vendimit të Komisionit vlerësues, pala e pakënaqur mund të parashtojë ankesë me shkrim brenda 30a (tridhjetë) ditëve në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - MMPH, nga dita e pranimit të Vendimit.
- ☐ Për informata shtesë ju lutemi telefononi në numrin e telefonit: 038-200-43706 / 038-200-43732



Komuna e Klinës
Drejtori
Lorenc Marleku